



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06/PL001

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 30 qershor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Supreme:

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Gjykatëse Kristinë van den Vajngart

Gjykatës Mihael Bolander

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Ben Emerson

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(d), 33(6) dhe 48(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 59 dhe 193 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës Supreme për të vendosur në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Mbrojtjen e Ligjshmërisë kundër Vendimit mbi Apelin lidhur me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit (IA014/F00008) (“Kërkesa”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 31 mars 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Vendimin mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit lidhur me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit (“Vendimi i Kundërshtuar”), ku, ndër të tjera, hodhi poshtë apelin e z. Kadri Veseli kundër vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake për vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli.²

2. Më 29 qershor 2022, z. Veseli dorëzoi Kërkesën.

II. KLASIFIKIMI

3. Kërkesa është klasifikuar si konfidenciale dhe për rrjedhojë dhe ky vendim do të

¹ F00001, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Mbrojtjen e Ligjshmërisë kundër Vendimit mbi Apelin lidhur me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit (IA014/F00008), 29 qershor 2022 (konfidencial).

² IA14/F00008, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit lidhur me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit, 31 mars 2022 (konfidencial), para. 68. Versioni i redaktuar publik i Vendimit të Kundërshtuar u dorëzua po atë ditë. Shih IA14/F00008/RED.

ketë të njëjtin klasifikim në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë në pajtim me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

III. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të nenit 33(6) të Ligjit dhe kriterëve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërisë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse

Gjykatësen Kristinë van den Vajngart

Gjykatësin Mihael Bolander

në Panelin e Gjykatës Supreme për të vendosur mbi Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,

Kryetare e Dhomave të Specializuara

E enjte, 30 qershor 2022

Në Hagë,

Holandë